



Programi i Partneritetit Evropian me Komunitat

Raporti tremujor

1 korrik – 30 shtator, 2011

DRAFT



Programi Fardësiq EU



Swiss Agency for Development and Cooperation SDC



Engjëzoviq/Parbur



Programme funded by EU



Implementing Partner



European Partnership with Municipalities Programme

Përmbledhje

Takimi i parë Vjetor i Këshillit Drejtues të Programit të Partneritetit Evropian me Komunitat – EU PROGRES u mbajt në fund të korrikut të vitit 2011, në Bosilegrad, ku grumbulloi rreth 70 pjesëmarrës, duke përfshirë përfaqësuesit e 20 komunave pjesëmarrëse në Program. Edhe nikoqirët edhe musafirët, shumica e të cilëve e vizituan këtë pjesë të vendit për herë të parë, e mirëpritën faktin që takimi u mbajt në këtë qytet të izoluar logjistikisht. Për EU-PROGRES-in ishte ky edhe një konfirmim i vazhdimësisë së interesimit të bashkëpunëtorëve për Programin dhe aktivitetet e tij.

Gjashtë projekte, me vlerë mbi 1.4 milion EUR u aprovuan gjatë Takimit vjetor, që paraqesin angazhimin e plotë në aktivitetet e projekteve të Programit të linjës buxhetore deri më EUR 5,900,987 (duke përfshirë angazhimet në projektet e vogla të aprovuara nga Këshilli drejtues por që ende nuk janë kontraktuar) që përbëjnë EUR 2,210,744. Edhe pse ekziston një ritëm i qëndrueshëm në shpërndarjen e fondeve, norma e shpenzimit, që ka qenë vetëm një e treta e fondeve të angazhura, ende mbetet sfida më e madhe. Disa komuna kanë kërkuar ndërprerje të kontratës për shkak të pamundësisë për të kontribuar me ko-financimin e tyre. Nga ana tjetër, disa vetqeverisje lokale, siç është qyteti i Leskocit, kanë marrë kredi bankare dhe kanë paguar kontributin e tyre 100%.

Siç sqarohet në raport, një sfidë tjetër e Programit është edhe mungesa e ofertave kualitative të arritura përmes tendereve të hapura, gjë që ka kërkuar vazhdimin e afateve të parashikuara më herët. Kjo në kontinuitet influencon afatet e implementimit dhe është e pashmangshme që aktivitetet të vonohen. Për më tepër, disa oferta të arritura nuk paraqesin vlerë të mirë për paratë dhe negociata me ofertuesit u desht të organizohen në të paktën dy raste, edhe pse të dyja rastet ishin të pasuksesshme.

Së fundi, situata politike nuk ka ndihmuar mbarëvajtjen e Programit. Koalicionet lokale janë të brishta dhe tanimë fushatat zgjedhore kanë filluar të përgatiten jozyrtarisht. Ka pasur rritje të lehtë të tensioneve në jug dhe jug-perëndim të Serbisë, që analistët e lidhin me situatën në veri të Kosovës. U mbajtën të paktën dy proteste të mëdha kundër “Diskriminimit të qeverisë”, përderisa në jug-perëndim Myftiu Muamer Zukorliq ftoi mbështetësit e vet për trazira civile dhe mosbindje.

Misioni i gjashtë Zviceran, për qeverisje të mirë u mbajt gjatë tremujorit të tretë dhe rezultoi në arritjen e marrëveshjes për mbështetje të ekspertëve në dy vitet e ardhshme dhe marrëveshje me SDC për të finalizuar fazën e ardhshme të financimit të Programit gjatë shtatorit dhe tetorit pasi që marrëveshja aktuale skadon më 31 tetor, 2011. Projektet e vogla të infrastrukturës dhe të paktën një projekt ndër-komunal do të shfaq fuqimisht qeverisjen e mirë; të gjitha EU-PROGRES komponentat do të vazhdojnë të respektojnë parimet e menaxhimit të mirë; do të ketë reformë të plotë të qeverisjes në të paktën një komunë, përderisa do të bëhen përpjekje të vazhdohet me dimenzionin vertikal të vetqeverisjes së mirë dhe kjo do të formalizohet në marrëveshjen e ardhshme me SDC-në.

Ky raport është strukturuar në pesë kapituj, që ofrojnë një pasqyrë të progresit të aktiviteteve të EU-PROGRES-it dhe rrethanat që kanë ndikim në implementimin e Programit. Kapitulli 1 paraqet një pasqyrë të përgjithshme të objektivave, qëllimeve, dhe shfrytëzuesve, përderisa pasqyra politike, sociale dhe kushtet ekonomike janë prezantuar në pjesën e Programit, në Kapitullin 2, përshkrimi i EU-PROGRES-it të çdo komponente është përshkruar në Kapitullin 3 dhe përshkrimi i punëve



Programme funded by EU



Implementing Partner



European Partnership with Municipalities Programme

administrative të programit është prezantuar në Kapitullin 4. Kapitulli 5 përmban informata mbi vizibilitetin për periudhën korrik-shtator 2011, dhe anekset vijuese ofrojnë informata më të hollësishme për aktivitetet më të rëndësishme.

DRAFT